Република Северна Македонија - Republika e Maqedonisë së Veriut
Општина Теарце - Komuna e Tearcës
Бр.-Nr. 01-197/1
04.02.2026 год./viti
Теарце - Tearcë
Tearcë 1224, R. e Maqedonisë së Veriut | 044 381 336; 044 381 443 | komunatearce@tearce.gov.mk | www.tearce.gov.mk

Врз основа начлен 50 став 1 од Законот за локалната самоуправа ("Службен Весник на Република Македонија" бр.05/02) и „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 202/24), член 34 од Статутот на Општина Теарце (бр.03/07 ; 09/11) и член 9 од Законот за вработените во јавниот сектор („Службен весник на Република Македонија" (бр.27/14, 199/14, 27/16, 35/18, 198/18) и („Службен весник на Република Северна Македонија" бр.143/19 , 14/20 , и 208/24), Градоначалникот на Општина Теарце донесе:

Në bazë të nenit 50 paragrafit 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e RM”, nr.5/2002, dhe Gazeta Zyrtare e RMV-së nr. 202/24) , nenit 34 të Statutit të Komunës së Tearcës dhe nenit 9 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (nr.27/14, 199/14, 27/16, 35/18, 198/18) dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë se Veriut" nr. nr.143/19 , 14/20 , и 208/24) , Kryetari i Komunës së Tearcës miratoi:

ЕТИЧКИ КОДЕКС
за однесување на вработените во Општина Теарце

1. ОПШТИ ОДРЕДБИ

ПРЕДМЕТ

Член 1

Со овој кодекс се пропишуваат етичките стандарди и правила за однесување на вработените во Општина Теарце (во понатамошниот текст: општината).

ЦЕЛ
Член 2

Целта на етичкиот кодекс е поттикнување на доброто постапување и однесување на вработените, унапредување на достоинството и на угледот на вработените и зајакнување на довербата на граѓаните во работата на Општината.

ПРИМЕНА
Член 3

Вработените во Општината ги применуваат правилата на однесување и етичките стандарди во односите со колегите, со претпоставените и со странките, на нивното работно место и во јавноста.

KODEKSI ETIK
për sjelljen e të punësuarve në Komunën e Tearcës

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

LËNDA

Neni 1

Me këtë kodeks përcaktohen standardet dhe rregullat etike për sjelljen e punonjësve në Komunën e Tearcës (në tekstin e mëtejmë: Komuna).

QËLLIMI
Neni 2

Qëllimi i kodeksit etik është inkurajimi i sjelljes së mirë të punonjësve, përmirësimi i dinjitetit dhe reputacionit të punonjësve dhe forcimin e besimit të qytetarëve në punën e Komunës.

ZBATIMI
Neni 3

Punonjësit në Komunë i zbatojnë rregullat e sjelljes dhe standardet etike në marrëdhëniet e tyre me kolegët, eprorët dhe palët, në vendin e tyre të punës dhe në publik.

Tearcë 1224, R. e Maqedonisë së Veriut | 044 381 336; 044 381 443 | komunatearce@tearce.gov.mk | www.tearce.gov.mk

ОСНОВНИ ПРИНЦИПИ
Член 4

Вработениот во општинската администрација во вршењето на работите и работните задачи се води од следните основни принципи:
- професионалност
- одговорност
- стручност
- совесност
- ефикасност
- ефективност
- навременост
- уредности и
- чесност.

PARIMET THEMELORE
Neni 4

Punonjësi në administratën komunale në kryerjen e punëve dhe detyrave udhëhiqet nga këto parime themelore:
- profesionalizmi
- përgjegjësia
- ekspertiza
- ndërgjegjshmëria
- efikasiteti,
- efektiviteti
- afati kohor
- rregullsia dhe
- ndershmëria.

ЕТИЧКИ СТАНДАРДИ И ПРАВИЛА НА ОДНЕСУВАЊЕ

Член 5

Однесувањето на вработените во Општината треба да се темели врз принципите на законитост, личен интегритет, почитување на демократските вредности, социјални права и недискриминација, транспарентно и одговорно постапување со информации, професионалност, стручност и ефикасност, економично ефикасно користење на ресурсите, политичка неутралност, добро однесување со колегите и со претпоставените и пристојно облекување.

STANDARDET ETIKE DHE RREGULLAT E SJELLJES

Neni 5

Sjellja e punonjësve në Komunë duhet të bazohet në parimet e ligjshmërisë, integritetit personal, respektimit të vlerave demokratike, të drejtave sociale dhe mos-diskriminimit, trajtimin transparent dhe të përgjegjshëm të informacioneve, profesionalizëm dhe efikasitet, shfrytëzim ekonomik dhe efikas të burimeve, neutralitet politik, sjellje të mirë me kolegët dhe eprorët dhe veshje të denjë.

ЗАКОНИТОСТ
Член 6

Вработените се должни да ги извршуваат своите работи и работни задачи во согласност со Уставот и законите на Република Северна Македонија, меѓународните договори ратификувани во согласност со Уставот и во согласност со интерните правила и акти на Општината.
Вработените не смеат и не треба да работат на начин за кој знаат или се сомневаат дека е незаконски, непрописен или неморален и доколку им се дадат такви работни задачи случајот веднаш да го пријават на овластени лица и институции согласно закон.

LIGJSHMËRIA
Neni 6

Punonjësit janë të obliguar që punën dhe detyrat e tyre t'i kryejnë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën dhe në pajtim me rregullat dhe aktet e brendshme të Komunës.
Punonjësit nuk duhet dhe nuk guxojnë të punojnë në atë mënyrë që ata e dinë ose dyshojnë se është e paligjshme, e parregullt ose e pamoralshme dhe nëse u jepen detyra të tilla pune, ata duhet të raportojnë menjëherë rastin tek personat dhe institucionet e autorizuara në përputhje me ligjin.

ЛИЧЕН ИНТЕГРИТЕТ

Член 7

Вработените со својот личен пример промовираат почитување на етичките принципи, , праведност, професионалност, совесност, одговорност и доверливост кон колегите и странките со цел остварување на функциите на Општината и одржување на угледот на институцијата.

INTEGRITETI PERSONAL

Neni 7

Punonjësit me shembullin e tyre personal , promovojnë respektimin e parimeve etike, ndershmërinë , drejtësinë, profesionalizmin, ndërgjegjen, përgjegjësinë dhe besueshmërinë ndaj kolegëve dhe palëve për të përmbushur funksionet e Komunës dhe për të ruajtur reputacionin e institucionit.

ДЕМОКРАТСКИ ВРЕДНОСТИ

Член 8

Вработените во своето работење ја промовираат демократичките вредности и владеењето на правото и ги почитуваат принципите на хуманост, еднаквост, недискриминација и социјална правда. Вработените одобгваат дискриминација по основ на пол, возраст, етно или социјално потекло, јазична, верска припадност, брачен статус, здравствено состојба или на каква било друга основа.

VLERAT DEMOKRATIKE

Neni 8

Punonjësit me punën dhe sjelljen e promovojnë vlerat demokratike dhe sundimin e ligjit dhe respektojnë parimet e humanizmit, barazisë, mosdiskriminimit dhe drejtësisë sociale.

Punonjësit shmangin diskriminimin në bazë të gjinisë, moshës, prejardhjes etnike ose sociale, gjuhës, fesë, statusit martesor, gjendjes shëndetësore ose në çfarë do lloj baze tjetër. Punonjësit sigurojnë standarde të barabarta në ofrimin e shërbimeve, nëpërmjet trajtimit të drejtë dhe të barabartë.

ТРАНСПАРЕНТНОСТ И ОДГОВОРНО ПОСТАПУВАЊЕ СО ИНФОРМАЦИИ

Член 9

За сите граѓани кои ги користат услугите на Општината се обезбедуваат веродостојни, навремени, квалитетни и целосни информации, притоа почитувајќи го правото на приватност и заштитата на личните податоци.

TRANSPARENCA DHE TRAJTIMI I PËRGJEGJSHËM I INFORMACIONIT

Neni 9

Të gjithë qytetarëve që përdorin shërbimet e Komunës u sigurohet informacion i besueshëm, në kohë, cilësor dhe i plotë, duke respektuar të drejtën e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

ПРОФЕСИОНАЛНОСТ, СТРУЧНОСТ И ЕФИКАСНОСТ

Член 10

Вработените се должни да ја вршат својата работа професионално, посветено и навремено почитувајќи ги приоритетите и редоследот на задачите. Работите и работните задачи да ги извршуваат одговорно, стручно и ефикасно со примена на нивните најдобри знаења и вештини, да го следат развојот во својата област, континуирано да се надоградуваат и обучуваат и да ги применуваат стекнатите нови знаења, заради личен напредок и зголемување на ефикасноста во Општината.

Вработените имаат обврска при учество на работни состаноци, обуки и други видови на стручно оспособување и усовршување достојно да ја

PROFESIONALIZËM, EKSPERTIM DHE EFIKASITET

Neni 10

Punonjësit janë të obliguar që punën e tyre ta kryejnë në mënyrë profesionale, me përkushtim dhe në kohë, duke respektuar prioritetet dhe radhën e detyrave. Punët dhe detyrat e punës t'i kryejnë me përgjegjësi, profesionalizëm dhe efikasitet duke zbatuar njohuritë dhe aftësitë e tyre më të mira, për të ndjekur zhvillimin në fushën e tyre, në mënyrë të vazhdueshme të përmirësohen dhe trajnohen dhe të zbatojnë njohuritë e reja të marra, për hir të progresit personal dhe rritjes së efikasitetit në Komunë.

Punonjësit kanë për obligim që ta përfaqësojnë Komunën në mënyrë të denjë kur marrin pjesë në takime pune, trajnime dhe lloje të tjera të aftësimit dhe zhvillimit

ЕКОНОМИЧНО И ЕФИКАСНО КОРИСТЕЊЕ НА РЕСУРСИТЕ

Член 11

Вработените обезбедуваат економично ефикасно управување и користење материјалните средства, опремата и предметите што им се доверени во извршување на работните задачи и го спречуваат нивното незаконски користење и располагање.

Вработените не смеат да ги користат за приватни потреби средствата, предметите или опремата што им е доверена на располагање и користење заради извршување на работните задачи.

ПОЛИТИЧКА НЕУТРАЛНОСТ

Член 12

Вработените ги вршат работите и работните задачи политички неутрално, без да ги извразуваат своите политички ставови и уверувања при вршењето на службените задачи.

Вработените не ја истакнуваат, ниту ја наметнуваат на други својата политичка определба. Вработените не смеат во просторите општинската зграда да носат или истакнуваат обележја на политички парти ниту нивен пропаганден материјал.

Вработените се должни да ја чуваат независноста на Општината од активностите на политичките парти.

ДОБРО ОДНЕСУВАЊЕ СО КОЛЕГИТЕ И СО ПРЕТПОСТАВЕНИТЕ

Член 13

Вработените во односот со колегите ги негуваат духот и начелата на тимска работа, взаемно почитување, почитување на различностите, солидарност и соработка. Се почитува приватноста и дискрецијата на колегите и претпоставените. Комуникацијата и соработката се одвива на начин кој не го повредува достоинството и личниот интегритет, туку придонесува за создавање на пријатна работна атмосфера, толерантност, транспарентност и меѓусебно разбирање.

SHFRYTËZIMI EKONOMIK DHE EFIKAS I BURIMEVE

Neni 11

Punonjësit sigurojnë menaxhim dhe shfrytëzim ekonomik dhe efikas të mjeteve materiale, pajisjeve dhe objekteve që u janë besuar në kryerjen e detyrave të punës dhe parandalojnë përdorimin dhe asgjësimin e tyre të paligjshëm. Punonjësit nuk mund t'i përdorin mjetet për nevoja private, sendet ose pajisjet që i janë besuar në shfrytëzim dhe përdorim me qëllim të kryerjes së detyrave të punës.

NEUTRALITETI POLITIK

Neni 12

Punonjësit i kryejnë punët dhe detyrat e tyre në mënyrë politikisht neutrale, pa shprehur pikëpamjet dhe bindjet e tyre politike gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare.

Punonjësit nuk theksojnë apo imponojnë përkatësinë e tyre politike tek të tjerët.

Punonjësit nuk mund të mbajnë ose ekspozojnë simbolet e partive politike apo materialet e tyre propagandistike në ambientet e ndërtesës së Komunës.

Punonjësit janë të obliguar të mbrojnë pavarësinë e Komunës nga aktivitetet e partive politike.

SJELLJE E MIRË ME KOLEGËT DHE EPRORËT

Neni 13

Punonjësit në marrëdhëniet e tyre me kolegët kultivojnë frymën dhe parimet e punës në grup, respektin reciprok, respektin për diversitet, solidaritet dhe bashkëpunim. Respektohet privatësia dhe liria e kolegëve dhe eprorëve. Komunikimi dhe bashkëpunimi zhvillohet në një mënyrë që nuk cenon dinjitetin dhe integritetin personal, përkundrazi, kontribuon në krijimin e një atmosfere të këndshme pune, tolerancës, transparencës dhe mirëkuptimit të ndërsjelle.

ПРИСТОЈНО ОБЛЕКУВАЊЕ

Член 14

Вработените посветуваат внимание на хигиената, изгледот и начинот на облекување, за да не предизвикаат впечаток на непријатност и нарушување на угледот на институцијата. Облеката на вработените треба да биде чиста, формална и уредна. Во Општината не се дозволува премногу кратка, тесна, отворена или вулгарна облека која содржи непристојни натписи. Формалниот и пристојниот начин на облекување ја изразува почитта на вработените кон службата, но кон колегите, претпоставените и странките.

VESHJA E PËRSHTATSHME

Neni 14

Punonjësit i kushtojnë vëmendje pastërtisë, pamjes dhe mënyrës së veshjes, në mënyrë që të mos krijojnë përshtypjen e shqetësimit dhe dëmtimit të reputacionit të institucionit. Veshja e punonjësve duhet të jetë e pastër, zyrtare dhe e rregullt. Në Komunë nuk lejohen veshje shumë të shkurtra, të ngushta, të hapura apo vulgare që përmbajnë mbishkrime të pahijshme. Veshja formale dhe e denjë shpreh respektin e punonjësve për shërbimin, por edhe për kolegët, eprorët dhe palët.

ЗАБРАНА ЗА ПУШЕЊЕ ВО СИТЕ РАБОТНИ ПРОСТОРИИ

Член 15

Во сите работни простории на зградата на Општина мора да има видливо истакнат знак за забрането пушење. Се забранува пушење во сите работни простории и други затворени простории(на прим.Сов.сала) согласно со одредбите на Законот за заштита од пушењето. Пушење е дозволено исклучиво надвор од деловниот објект на отворен простор.

NDALIMI I DUHANIT NË TË GJITHA HAPËSIRAT E PUNËS

Neni 15

Në të gjitha hapësirat e punës së Komunës duhet të jetë i vendosur në mënyrë të dukshme një shenjë që ndalon pirjen e duhanit. Ndalimi i pirjes së duhanit zbatohet në të gjitha hapësirat e punës dhe hapësira tjera të mbyllura (psh. Salla e Këshillit), në përputhje me dispozitat e Ligjit të Mbrojtjes nga Duhanpirja. Pirja e duhanit lejohet vetëm jashtë ndërtesës zyrtare, në hapësira të hapura.

АКТИВНОСТИ НАДВОР ОД РАБОТНОТО МЕСТО

Член 16

Финансискиот интерес вклучува каква било корист за вработениот во општинската администрација, неговото семејство, родниците, пријателите, за физички и правни лица со кои има или имал деловни врски. Вработените, за себе или за друг, не барат и не примат подароци, услуги, помош или каква било друга корист, која би можела да има влијание или да се чини дека ќе има влијанија на нивното постапување со што би се довел во прашање нивниот професионален пристап кон работата и работните задачи кои ги извршува. Вработените не смеат да прифатат подароци или благодарност која би се сметала како награда за работата чие извршување е нивна должност.

AKTIVITETE JASHTË VENDIT TË PUNËS

Neni 16

Interesi financiar përfshin çdo përfitim për punonjësin e administratës komunale, familjen, të afërmit, miqtë e tij, për personat fizikë dhe juridikë me të cilët ka ose ka pasur marrëdhënie biznesi.

Punonjësit, për veten e tyre apo për tjetër kënd, nuk kërkojnë dhe nuk marrin dhurata, favore, ndihmë apo ndonjë përfitim tjetër që mund të ndikoje ose duket se ndikon në veprimet e tyre, gjë që do të vinte në pikëpyetje qasjen e tyre profesionale ndaj punës dhe detyrave qe i kryen.

Punonjësit nuk duhet të pranojnë dhurata ose mirënjohje që do të konsideroheshin si shpërblim për punën, kryerja e së cilës është detyrë e tyre.

III. ПРИМЕНА НА ОДРЕДБИТЕ ОД КОДЕКСОТ

Член 17

Раководителите на организациските единици во Општината се должни со своето лично однесување да дадат пример за етичко однесување на вработените.
Непосредните раководители ги запознаваат вработените во организационата единица со која раководат со одредбите од Кодексот.
Непосредно претпоставение раководители ја следат примената на овој Кодекс, укажуваат на пропусти во текот на работата и преземаат мерки во случај на повреда на етичките стандарди и правилаутврдени со овој Етички кодекс и во согласност со позитивните правни прописи.

III. ZBATIMI I DISPOZITAVE TË KODEKSIT

Neni 17

Udhëheqësit e njësive organizative në Komunë janë të detyruar me sjelljen e tyre personale të japin shembull të sjelljes etike për të punësuarit.
Udhëheqësit i njoftojnë të punësuarit në njësinë e tyre organizative me të cilat udhëheqin me dispozitat e Kodeksit. Udhëheqësit eprorë të drejtpërdrejtë monitorojnë zbatimin e këtij Kodeksi, tregojnë lëshimet gjatë punës dhe marrin masa në rast të shkeljes së standardeve dhe rregullave etike të përcaktuara me këtë Kodeks të Etikës dhe në përputhje me rregulloret ligjore pozitive.

НЕПОЧИТУВАЊЕ

Член 18

Вработените се должни да се придржуваат кон одредбите на Кодексот. За постапување спортивни на одредбите од овој Кодекс, вработените во Општината одговараат дисциплински согласно одредбите од Законот за административни службеници и подлежат на содветна одговорност согласно важечките законски и подзаконски прописи.

MOSRESPEKTIMI

Neni 18

Punonjësit janë të detyruar të respektojnë dispozitat e Kodeksit. Për të vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodeksi, punjonësit e Komunës i nënshtrohen masave disiplinore në përputhje me dispozitat e Ligjit për nëpunësit administrativë dhe i nënshtrohen përgjegjësisë së duhur në përputhje me rregulloret ligjore dhe nënligjore në fuqi.

ПРИЈАВУВАЊЕ

Член 19

Вработените кои сметат дека од нив се бара да постапуваат спротивно на одредбите на овој кодекс тоа го пријавуваат, до градоначалникот на Општина Теарце.
Вработените го известуваат градоначалникот на Општина Теарце и кога сметат дека постои кршење на одредбите на овој кодекс од страна на други вработени во општината.
Вработените кои го доставуваат известувањето од став 1 и 2 од овој член не смеат истото да го прават за остварување на лични интереси. Вработените кои извршиле пријавување од став 1 и 2 од овој член врз разумна основа и со чесни намери не може да бидат повикани на одговорност за пријавувањето.

PARAQITJA

Neni 19

Punonjësit, të cilët mendojnë se u kërkohet të veprojnë në kundërshtim me dispozitat e këtij kodeski, duhet t'i raportojnë përkatësisht kryetarit të Komunës së Tearcës.

Punonjësit e njoftojnë kryetarin e komunës kur mendojnë se ka shkelje të dispozitave të këtij kodeksi nga punëtorë tjerë në Komunë.

Punonjësit të cilët, dorëzojnë njoftimin nga paragrafi 1 dhe 2 i ketij neni nuk mund ta bëjnë këtë për interesa personale.Punonjësit të cilët kanë kryer paraqitje nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni në baza të arsyeshme dhe me qëllime të ndershme nuk mund të mbajnë përgjegjësi për paraqitjen.

ПОТПИШУВАЊЕ НА ИЗЈАВА

Член 20

Вработените потпишуваат изјава со која потврдуваат дека ги прочитале и разбрале принципите и стандардиде на однесување и работење содржани во Кодексот.

Потпишаните изјави се доставуваат и чуваат во одделението за управување со човечки ресурси. Образецот од Изјавата е составен дел од Кодексот даден во Прилог бр. 1

Секое лице кое за првпат заснова работен однос во Општина Теарце задолжително се запознава со одредбите од овој Кодекс од страна на непосредно предпоставениот раководител.

NËNSHKRIMI I DEKLARATËS

Neni 20

Punonjësit nënshkruajnë deklaratë që konfirmon se kanë lexuar dhe kuptuar parimet dhe standardet e sjelljes dhe punës të përfshira në Kodeks.

Deklaratat e nënshkruara dorëzohen dhe mbahen në njësinë për Menaxhim me Burimet Njerëzore. Formulari i deklaratës është pjesë përbërëse e Kodeskti të dhënë në Aneksin numër 1.

Çdo person i cili për herë të parë themelon marrëdhënie pune në Komunën e Tearcës duhe të njihet me dispozitat e këtij Kodeksi nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë.

IV. ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

ВЛЕГУВА ВО СИЛА И ОБЈАВУВАЊЕ

Член 21

Овој кодекс влегува во сила со денот на донесување, а ќе се објавува во Службен Гласник и интернет страница на Општина Теарце.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 21

Ky kodeks hyn në fuqi që në ditën e miratimit dhe do të publikohet në Fletorën Zyrtare dhe në uebfaqen e Komunës së Tearcës.

Градоначалник на Општина Теарце
Kryetari i Komunës së Tearcës
DAUT MEMISHI

Република Македонија - Република е Северна Македонија
Општина Теарце - Komuna e Tearcës
Теарце
Tearcë

Прилог бр. 1

Врз основа на член 19 од Етичкиот кодекс за однесување на вработените во Општина Теарце ја давам следната изјава

ИЗЈАВА

Јас _____, вработен/а во Општина Теарце на работно место _____, во сектор/одделение _____, потврдувам дека сум запознаен/а со правилата на однесување на вработените (Етичкиот кодекс) во Општина Теарце и изјавувам дека истите доследно ќе ги почитувам и ќе се придружам до истите при извршување на работните задачи.

Датум и место
_____

Име и презиме, потпис
_____

Shtojcë nr. 1

Në bazë të nenit 19 të Kodeksit të Etikës për sjelljen e punonjësve në Komunën e Tearcës, jap deklaratën si në vijim

DEKLARATË

Unë _____, i/e punësuar në Komunën e Tearcës, në vendin e punës _____, në Sektorin/Njësinë _____, vërtetoj se jam i/e njoftuar me rregullat e sjelljes së punonjësve (Kodeksi i Etikës) në Komunën e Tearcës dhe deklaroj se, të njëjtat në vazhdimësi do t'i respektoj dhe do t'u përmbahem gjatë kryerjes së detyrave të punës.

Data dhe vendi
_____

Emri dhe mbiemri, nënshkrimi
_____